



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**SHPLLJE PËR
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË
KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhetë kreut II, IV dhe VII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, urdhrit nr. 36, datë 13.01.2025 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2025”, njësia përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik shpall procedurën e lëvizjes paralele, dhe pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive për pozicionin:

**“Specialist Jurist” në Sektorin e Monitorimit të Zbatimit të Vendimeve dhe Shërbimit Ligjor në Drejtorinë e Monitorimit Shërbimeve Mbështetëse dhe Financës në Komisionin e Prokurimit Publik -
Kategoria: IV-1, një vend vakant.**

Pozicioni më sipër, i ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve:	Shih procedurat përkatëse
Deri në 11.09.2025	Lëvizja paralele
Deri në 16.09.2025	Pranim në shërbimin civil

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin më sipër është:

1. Kryen dhënien e asistencës dhe interpretimit ligjor për njohjen më të mirë për strukturat e komisionit, duke kryer funksion teknik në funksion të veprimtarisë së institucionit.
2. Kryen monitorimin e zbatimit të vendimeve si dhe siguron përfaqësimin ligjor në organet gjyqësore për të gjitha çështjet ku komisioni është palë.
3. Verifikon dhe konfirmon zbatimin e legjislacionit në fuqi për çështjet që i propozohen për miratim Kryetarit të Komisionit (urdhrrat normativë dhe individualë);

4. Ofron asistencën ligjore në procesin e hartimit, standardizimit, dhe përmirësimit të kontratave, akt-marrëveshjeve, memorandumëve të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit, duke u bazuar në informacionin teknik për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve si dhe përputhshmërinë me përcaktimet e akteve ligjore e nënligjore që janë në fuqi;
5. Ofron konsulencës së nevojshme ligjore si dhe të kontribuojë në zgjidhjen e kërkesave për gjetjen e opsioneve dhe hapësirave ligjore mbi problemet që parashtrihen në rrugë administrative, për çështje me natyrë ligjore (juridike) nga strukturat e Komisionit;
6. Kontribuon në përmirësimin e procedurave që ndiqen për dhënien e asistencës ligjore;
7. Ofron asistencën ligjore në procesin e hartimit, përmirësimit të Rregulloreve dhe manualeve të Komisionit duke aplikuar standardet më të mira në to;
8. Kryen hartimin e materialeve, si dhe të sigurojë ndjekjen dhe respektimin e procedurave dhe afateve ligjore, për të siguruar pjesëmarrje me performancë të lartë profesionale, në interesin e institucionit për të gjitha shkallët e gjyqkimit;
9. Të sigurojë informacion të specializuar dhe dokumentacion të nevojshëm, që do të shërbejnë në cilësinë e provave, në të gjitha shkallët e gjyqkimit, nëpërmjet bashkëpunimit me strukturat e tjera të institucionit;
10. Merr pjesë në grupe pune apo komisione takime pune, seminare, konferenca ose takime të tjera me urdhër të eprorit.
11. Kryen detyra të tjera përkatëse që i ngarkohen nga eprori direkt.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon (kategoria IV-1);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të plotësojë kriteret e veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimimi:

Të zotërojnë minimumi diplomë të nivelit “**Master Profesional**” në **Shkenca Juridike**. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë; **një vend vakant.**

I.

Përvoja:

Të ketë 1 (një) vit eksperiencë pune.

Tjetër:

a- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;

- b- aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi; aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, **dokumentet origjinalë (ose të njehësuar me origjinalin)** si më poshtë:

- 1) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>;
- 2) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur, duke specifikuar llojin e procedurës së rekrutimit për të cilin po aplikohet; (origjinal);
- 3) Dokumentin origjinal ose fotokopje të njehësuar me origjinalin (përfshirë edhe diplomën Bachelor). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 4) Listë notash, fotokopje të njehësuar me origjinalin;
- 5) Fotokopje të njehësuar me origjinalin të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 6) Fotokopje të njehësuar me origjinalin të letërnjoftimit (ID) ose pasaportës;
- 7) Vërtetim të gjendjes shëndetësore, (e periudhës që aplikon);
- 8) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (e periudhës që aplikon);;
- 9) Letër motivimi për aplikim në vendin vakant (origjinal);
- 10) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj, të njehsuara me origjinalen;
- 11) Aktin e emërimit si nëpunës civil, (fotokopje të njehësuar me origjinalin);
- 12) Vërtetimin ku specifikohet kategoria e pagës në pozicionin aktual që ushtron kandidati, (fotokopje të njehësuar me origjinalin);
- 13) Vlerësimin e fundit nga eprori direkt; (vlerësim të 6-mujorit të fundit dhe vlerësim të pjesshëm (deri në momentin e aplikimit));
- 14) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi, i cili duhet të jetë i muajit të aplikimit;
- 15) Të dorëzojnë dokumentet e parashikuara në pikën 1.2.

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara, sjell skualifikimin e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 11.09.2025, në Zyrën e Protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, Blv “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **15.09.2025**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, dhe në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e institucionit, nëpërmjet adresës së e-mailit, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga shpallja e listës dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

1.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar;
- Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;
- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- Ligji nr.125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- Vendimi nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.575, datë 10.07.2013 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.1719, datë 17.12.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar;
- Vendimi nr.320, datë 21.4.2011 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave e të kriterëve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar;
- Vendimi nr.401, datë 13.05.2015 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimimi ndaj procedurave të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”;
- Vendimi nr.766, datë 13.10.2021 “Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KPP-së”;

1.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit për Lëvizje Paralele, i ngritur në KPP, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

- **Kandidatët do të vlerësohen:** për përvojën (20 pikë), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pikë), si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer (10 pikë). Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.
- **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**
 - a- njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
 - b- eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - c- motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al) në lidhjen <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Komisioni në përfundim të vlerësimit, njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komitetin e Përhershëm të Pranimit për Lëvizjen Paralele për rezultatin e vlerësimit, brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 3 (tre) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit. Komisioni brenda 24 (njëzetë e katër) orëve pas përfundimit të procedurave të ankimit, përzgjedh kandidatin, i cili renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë.

1.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse e Komisionit të Prokurimit Publik do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KPP-së. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

2- PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Këtë informacion do ta merrni në faqen e KPP-së, pas datës 15.09.2025.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

2.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL - KRITERET E VEÇANTA

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimi në shërbimit civil janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

Arsimimi:

Të zotërojnë minimumi diplomë të nivelit “**Master Profesional**” në Shkenca Juridike. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë; **një vend vakant**.

Përvoja:

Të ketë 1 (një) vit eksperiencë pune.

Tjetër:

- a- të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup;
- b- aftësi për të planifikuar, rishikuar dhe drejtuar punën e stafit nën varësi; aftësi shumë të mira komunikimi, prezantimi;

2.2

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, **dokumentet origjinalë (ose të njehësuar me origjinalin)** si më poshtë:

- 1) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në lidhjen <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>;
- 2) Kërkesë për të konkurruar në pozicionin e shpallur, duke specifikuar llojin e procedurës së rekrutimit për të cilin po aplikohet;

- 3) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) të njehsuar me origjinalin. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- 4) Listë notash, fotokopje të njehsuar me origjinalin
- 5) Fotokopje të njehsuar me origjinalin të librezës së punës (të gjithë faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- 6) Fotokopje të njehsuar me origjinalin të letërnjoftimit (ID) të njehsuar me origjinalin;
- 7) Vërtetim të gjendjes shëndetësore (e periudhës që aplikon);
- 8) Vërtetim i gjendjes gjyqësore (e periudhës që aplikon);
- 9) Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
- 10) Dokumentin origjinal ose fotokopje të njehsuar me origjinalin të çdo dokumentacioni tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin;
- 11) Të dorëzojnë dokumentet e parashikuara në pikën 2.2.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 16.09.2025, në Zyrën e Protokollit të Komisionit të Prokurimit Publik, Blv “Dëshmorët e Kombit”, Pallati i Kongreseve, Kati i parë, Tiranë.

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara, sjell skualifikimin e kandidatit.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil, do të informohen për fazat e mëtejshme të kësaj procedurë:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e KPP-së duke filluar nga data: 18.09.2025.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Prej datës **18.09.2025**, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, dhe në stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga Njësia Përgjegjëse e institucionit, nëpërmjet adresës së e-mailit, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët paraqiten në Njësinë Përgjegjëse brenda (5 (pesë) ditëve kalendarike dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) kalendarike pune nga data e depozitimit të saj.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Ligji nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurës Civile, i ndryshuar;
- Ligji nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar;
- Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- Ligji nr.8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- Ligji nr.125/2013 “Për konçesionet dhe partneritetin publik privat”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9874, datë 14.02.2008 “Për ankandin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.36/2020 “Për prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë”;
- Vendimi nr.285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.575, datë 10.07.2013 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar;
- Vendimin nr.1719, datë 17.12.2008 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të ankandit publik”, i ndryshuar;
- Vendimi nr.320, datë 21.4.2011 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave e të kritereve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurruese”, i ndryshuar;
- Vendimi nr.401, datë 13.05.2015 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj në një procedurë ankimimi ndaj procedurave të koncesionit/partneritetit publik privat, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”;
- Vendimi nr.766, datë 13.10.2021 “Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e KPP-së”;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në

lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr.2, datë 27.03.2015, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në lidhjen <http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

Komisioni në përfundim të vlerësimit, njofton individualisht kandidatët që kanë konkuruar për rezultatin e tyre. Kandidatët kanë të drejtë të bëjnë ankim me shkrim në Komitetin e Përhershëm të Pranimin për procedurën e pranimin në shërbimin civil për rezultatin e vlerësimit, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual mbi rezultatin. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatet do të vlerësohen nga Komiteti i Përhershëm i Pranimin për pranim në shërbimin civil në KPP, nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar, vlerësimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidateve është 100 pikë.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al në lidhjen <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/54-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>.

2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore (Njësia Përgjegjëse) pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë kandidatët në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të KPP-së, si dhe në stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për

rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail)*.

Kandidatët fitues janë ata që renditen të parët nga kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve). Njësia Përgjegjëse njofton individualisht kandidatët që kanë konkurruar për rezultatin e tyre brenda 24 (njëzetekatër) orëve nga dita që komiteti i njofton vendimin e tij. Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim edhe në KPP (Komiteti i Përhershëm i Pranimit) për rezultatin e pikëve brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual për rezultatin e vlerësimit. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data përfundimit të afatit të ankimit. Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të KPP-së . Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail)*.

2.7

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia Përgjegjëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, dhe në faqen zyrtare të KPP-së.

Të gjithë kandidatët pjesëmarrës që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil, do të marrin informacion për fazat e mëtejshme të kësaj procedure;

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- për datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e KPP-së duke filluar nga data **18.09.2025** e në vijim.